



DFJC - Département de la formation, de la jeunesse et de la culture  
DGEO - Direction générale de l'enseignement obligatoire

## Paraqitje e Ciklit 2

### Informim për prindërit

#### Shkalla e parë (Arsimi fillor)

Vitet nga 5P deri në 8P

Shkolla e detyrueshme shtrihet në njëmbëdhjetë vjet. Ajo synon që nxënësi të marrë dijeni dhe kompetenca, të zhvillojë dhe të ushtrojë aftësitë e veta intelektuale, krijuese, fizike e në punë dore, dhe të formojë gjykimin dhe personalitetin e vet. Shkolla i lejon nxënësit të përfshihet në jetën shoqërore, profesionale dhe qytetare përmes njohjes së vetvetes dhe të botës që e rrethon, si dhe përmes respektimit të të tjerëve.

Kjo fletëpalosjeparaqet ciklin e dytë fillor (ciklin 2). Me një kohëzgjatje prej 4 vjetësh, ai ndahet në dy gjysmë-cikle: vitet 5 dhe 6, të ndjekura nga vitet 7 dhe 8. Gjatë këtyre katër vjetëve, nxënësi i thellon njohuritë e mara gjatë ciklit të parë. Në fund të vitit të 8-të, sipas rezultateve të veta shkollore, nxënësi-ja orientohet për në shkallën e dytë (arsimin e mesëm) në dy drejtime dhe dy nivele. Faqet vijuese paraqesin karakteristikat e ciklit të dytë: lëndët e ndryshme dhe tabelën e orarit, mënyrat e vlerësimit, si dhe kushtet e orientimit në fund të këtij cikli.

[www.vd.ch/solarite](http://www.vd.ch/solarite)

Burimet: Loi sur l'enseignement obligatoire (LEO)  
Règlement d'application de la LEO (RLEO)  
Cadre général de l'évaluation (CGE)

Janë të besueshëm vetëm kuadri ligjor rregullues dhe Kuadri i përgjithshëm i vlerësimit (CGE), i cili trajton në mënyrë të tërësishme rastet e ndryshme.

## Marrëdhënia shkollë-familje

Shkolla siguron kryesisht arsimimin e fëmijëve dhe ua njeh prindërve përparësinë në fushën edukimit. Megjithatë, këto misione nuk janë përjashtuese, meqenëse bashkëpunimi i familjeve kërkohet në fushën e arsimimit dhe shkolla ndihmon familjet në fushën e edukimit.

Mësuesi-ja kujdestar-e i/e klasës, si dhe drejtorja e entit shkollor janë bashkëbiseduesit e privilegjuar të prindërve për sa i përket shkollimit të fëmijës së tyre, për faktin e marrëdhënies së afërsisë të tyre me gjendjen e tij.

Prindërit informohen rregullisht me nxëniet shkollore dhe vlerësimin që rrjedh prej tyre. Ata dëgjojnë para çdo vendimi të rëndësishëm që ka të bëjë me rrugëtimin shkollor të fëmijës së tyre. Vendimet përfundimtare i takojnë këshillit drejtues.

Të paktën një herë në vit, në parim në fillim të vitit shkollor, organizohet një seancë informuese për prindërit. Kjo bën të mundur ndër të tjera shpjegimin e zhvillimit të shkollimit, objektivave të planit mësimor dhe kushteve të vlerësimit.

Informacionet e shkollës komunikohen rregullisht përmes agjendës të nxënësit të cilën prindërit e nënshkruajnë në fund të çdo jave. Është pikërisht përmes kësaj që prindërit dhe mësuesit mund të kërkojnë një takim. Këto shkëmbime, që mund të bëhen në çdo moment të vitit shkollor, sigurojnë një bashkëpunim të mirë.

Masa pedagogjike plotësuese mund të merren kur kjo është e nevojshme për të siguruar përparimin e nxënësit. Shërbime të tjera mund të jepen nga psikologët, psikomotricienët, apo logopedistët në mjedisin shkollor (PPLS), në përputhje me procedurat e vendosura në entin shkollor sipas specifikave të veta.

Informacione pikërisht lidhur me pritjen parashkollore apo me shërbimet e tjera mund të merren pranë drejtorisë së entit shkollor.

## Fushat lëndore dhe tabela e orarit

Gjatë ciklit 2, nxënësi vazhdon të nxëniet dhe thellon kompetencat e veta në të gjitha fushat lëndore të Planit romand të studimeve (*Plan d'études romand*, PER). Gjuhët e huaja, si gjermanishtja (prej klasës së 5-të) dhe anglishtja (prej klasës së 7-të) dalin në tabelën e orarit dhe kontribuojnë në zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe kulturore të nxënësve.

Metodat e punës, strategjitë e të nxëniet, aftësia për të bashkëpunuar dhe për të komunikuar zhvillohen në dhënien e të gjitha lëndëve të PER-së. Tabela e orarit e vitit të 5-të dhe vitit të 6-të përbëhet nga 28 periudha, për të kaluar, qysh nga viti i 7-të, në 32 periudha.

### Plani romand i studimeve (PER)

[www.plandetudes.ch](http://www.plandetudes.ch)

PER-ja përcakton përmbajtjen e nxëniet të shkollimit të detyrueshëm për Zvicrën romande. Ai përshkruan atë që nxënësit duhet të mësojnë gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të shkollimit.

Në mënyrë të përgjithshme, **rastet limite** kanë të bëjnë me gjendjet në të cilat rezultatet e nxëniet-es përkatës-e janë shumë pak më të ulëta nga ato që kërkohen për të plotësuar kushtet e kalimit. Nocioni i rastit limit nuk zbatohet për vendimin e orientimit. Këshilli drejtues vendos kryesisht për rastet limite.

Këshilli drejtues çmon, me kërkesën e prindërve, **rrethanat e veçanta** të mundshme (për shembull një shkollim i trazuar rëndë e për një kohë të gjatë nga një sëmundje e zgjatur, nga mbërritja rishtazi nga një kanton tjetër apo nga jashtë vendit). Që një rrethanë e veçantë të merret parasysh, duhet që një sukses i mëvonshëm të gjykojë i mundshëm.

## Vlerësimi

Vlerësimi i punës të nxënësit komunikohet në agjendë në formën e notave që shkojnë nga 1 deri në 6 me gjysmë-pika (TS dhe TA). Nota 4 përkon me pragun e mjaftueshmërisë. Nota më e lartë është 6-ta, nota më e ulët 1-shi.

Mesataret e mara nga nxënësi organizohen me grupe lëndësh dhe vendimet lidhur me rrugëtimin e nxënësit bazohen në shumën e pikave të mara në secilin prej grupeve.

Në mbarim të semestrit dhe të vitit shkollor, jepet një vlerësim i gjendjes. Ai përmban një listë të notave dhe të mungesave, si dhe mesataret e lëndëve të përcaktuara me gjysmë-pikën më të afërt. Në fund të vitit shkollor, një buletin përmbledh vlerësimet globale sipas lëndëve dhe tregon, në fund të vitit të 6-të dhe të vitit të 8-të, vendimin lidhur me rrugëtimin e nxënësit. Ky buletin i bashkëngjitet librezës shkollore.

**Punët domethënëse (travaux significatifs, TS):** në mënyrë të rregullt dhe përgjatë tërë vitit, vlerësimi i punës shkollore të nxënësit bëhet me ndihmën e punëve domethënëse. Ato përbëjnë elementet thelbësore të vlerësimit. Çdo punë domethënëse synon të paktën një objektiv mësimor të përcaktuar nga Plani romand i studimeve (PER) me një apo disa prej përbërësve të tij që kanë qenë objekt i një mësimdhënieje.

**Punët e përvetësuara (travaux assimilés, TA):** një sërë punësh që verifikojnë vetëm përvetësimin e njohurive apo të teknikave specifike. Kjo tërësi punësh është objekt i një note për çdo lëndë. Për çdo lëndë, numri i këtyre punëve të përvetësuara nuk mund të kalojë një të katërtën e tërësisë së punëve të caktuara.

## Vitet 5 dhe 6

Në fund të vitit të 6-të, nxënësi kalon provimet kantonale të referencës (*Epreuve cantonale de référence*, ECR) në frëngjisht dhe në matematikë. Nota e çdo provimi merret parasysht në përlllogaritjen e mesatares vjetore të lëndës përkatëse, në të njëjtën mënyrë si një punë domethënëse (TS).

## Kalimi

Në fund të vitit të 5-të, nxënësi kalon automatikisht në vitin e 6-të.

Për të kaluar nga viti i 6-të në të 7-tin, nxënësi duhet të marë të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + NJM <sup>1</sup>	16 pika e sipër
Grupi II	artet vizuale + muzikë + veprimtari krijuese dhe punë dore	12 pika e sipër
<i>Rastet limite</i>	<i>e shumta 1,5 pikë pamjaftueshmëri e mbledhur në të dy grupet dhe e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri në një grup.</i>	

<sup>1</sup> Njohja e mjedisit: rigrupimi i lëndëve gjeografi - qytetari, histori - etikë dhe kulturë fetare, shkencat e natyrës.

## Viti i 7-të

### Kalimi

Në fund të vitit të 7-të, nxënësi kalon automatikisht në vitin e 8-të.

**Vendimet e kalimit dhe orientimit** mund të bëhen objekt i një **ankimi** pranë Departamentit: *Instruction des Recours, Département de la formation, de la jeunesse et de la culture, rue de la Barre 8, 1014 Lausanne*. Ankimi i motivuar bëhet me shkrim brenda një afati 10-ditor nga njoftimi i tij, me një kopje të vendimit të kundërshtuar.

## Viti i 8-të

Në fund të vitit të 8-të, nxënësi-ja që përmbush kushtet e kalimit orientohet për në drejtimin paragjimnazial ose drejtimin e përgjithshëm. Nxënësit-et që orientohen për në drejtimin e përgjithshëm ndahen pastaj në nivelin 1 (me kërkesa bazë) ose nivelin 2 (me kërkesa më të larta) për frëngjishten, matematikën dhe gjermanishten.

- A** Në fund të semestrit të 1-rë ribëhet një vlerësim i gjendjes. Ai përmban një listë të notave dhe të mungesave, si dhe mesataret sipas lëndëve.
- Mësuesi-ja kujdestar-e i-e klasës takon prindërit gjatë një bashkëbisedimi për një analizë të përbashkët të gjendjes të nxënësit në bazë të këtij vlerësimi të gjendjes.
- B** Në prill ose maj, nxënësi kalon provimet kantonale të referencës (ECR) në frëngjisht, matematikë dhe gjermanisht.
- Notat e këtyre provimeve merren parasysh në përlllogaritjen e mesatares vjetore të lëndës përkatëse në masën prej 30% (shembull përlllogaritjeje përballë).
- C** Në fund të semestrit të 2-të, nxënësi-ja kalon në bazë të buletinit vjetor. Fëmija orientohet pastaj në njerin prej drejtimeve dhe vihet në njerin prej niveleve prej këshillit drejtues të entit, me mendimin paraprak të këshillit të klasës dhe në bazë të po këtij buletini vjetor.

**Për të kaluar nga viti i 8-të në të 9-tin**, nxënësi duhet të marrë të gjitha pikat vijuese për grupet I, II dhe III:

Grupi I	frëngjisht <sup>2</sup> + matematikë <sup>2</sup> + gjermanisht <sup>2</sup> + shkencat e natyrës	16 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi - qytetari + histori - etikë dhe kulturë fetare	12 pika e sipër
Grupi III	artet vizuale + muzikë + veprimtari krijuese dhe punë dore	12 pika e sipër
<i>Rastet limite</i>	<i>e shumta 1,5 pikë pamjaftueshmëri të mbledhur në të tri grupet dhe e shumta 1 pikë pamjaftueshmëri në një grup.</i>	

<sup>2</sup> përfshirë ECR-në (shih shembullin e përlllogaritjes në faqen përballë).

Për të hyrë në **drejtimin paragjimnazial (voie pré-gymnasiale, VP)**, nxënësi duhet të marrë në vitin e 8-të të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:

Grupi I	frëngjisht <sup>3</sup> + matematikë <sup>3</sup> + gjermanisht <sup>3</sup> + shkencat e natyrës	20 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi - qytetari + histori - etikë dhe kulturë fetare	13,5 pika e sipër

<sup>3</sup> përfshirë ECR-në (shih shembullin e përlllogaritjes në faqen përballë).

Në **drejtimin e përgjithshëm (voie générale, VG)**, hyrja fillestare në nivele në frëngjisht, në matematikë dhe në gjermanisht, përcaktohet në mënyrën e më poshtme sipas lëndëve:

Niveli 1	mesatarja vjetore <sup>4</sup> e lëndës	deri në 4
Niveli 2	mesatarja vjetore <sup>4</sup> e lëndës	4,5 e sipër

<sup>4</sup> përfshirë ECR-në (shih shembullin e përlllogaritjes në faqen përballë).

# Procedura e orientimit

## gusht

Fillimi i vitit shkollor në klasën e 8-të

## shtator - tetor

(apo në një periudhë tjetër të vitit shkollor, sipas organizimit të secilit ent)  
Seancë informimi për prindërit e organizuar prej entit

A

## janar

Vlerësim i gjendjes për semestrin e 1-rë  
Analizë e përbashkët (shkollë - prindër) e gjendjes së nxënësit

B

## prill - maj

Provimet kantonale të referencës në frëngjisht, në matematikë  
dhe në gjermanisht

C

## qershor - korrik

Buletini vjetor  
Vendimi i kalimit dhe orientimit për në drejtime dhe, në VG, në nivele, i marë  
prej këshillit drejtues në funksion të rezultateve të nxënësit

## Viti i 9-të - shkalla e dytë I (arsimi i mesëm i ulët)

### drejtimi i përgjithshëm

frëngjisht

niveli 1

niveli 2

matematikë

niveli 1

niveli 2

gjermanisht

niveli 1

niveli 2

### drejtimi paragjimnazial

#### Mesatarja vjetore, shembull përlllogaritjeje

Mesatarja e notave të mara në klasë	4,9
Nota e ECR-së	4,5
Përlllogaritja: $(4,9 \times 0,7) + (4,5 \times 0,3) =$	4,78
<b>Mesatarja vjetore përfundimtare (e rrumbullakosur me gjysmë-pikë)</b>	<b>5</b>

# Drejt shkallës së dytë I (arsimit të mesëm të ulët)

Shkalla e dytë I përmban dy drejtime: drejtimin parajimnazial (*voie pré-gymnasiale*, VP) dhe drejtimin e përgjithshëm (*voie générale*, VG).

## Drejtimi parajimnazial

Drejtimi parajimnazial pret nxënësit që do të mund të hyjnë drejtpërdrejt në studimet e maturës gjimnaziale nëse marrin çertifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë. Nxënësit përzgjedhin një lëndë me zgjedhje specifike (OS) midis lëndëve të mëposhtme: ekonomisë dhe drejtësisë, italishtes, latinishtes apo matematikës e fizikës.

## Drejtimi i përgjithshëm

Drejtimi i përgjithshëm pret nxënësit që destinohen kryesisht për formimin profesional (të nxënit e një zanati), si dhe për në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale. Nxënësi ndjek lëndë me zgjedhje të kompetencave të orientuara drejt zanateve (OCOM): 2 periudha për grupin Formim i përgjithshëm janë për tërë klasën; sa i përket 2 periudhave të tjera, nxënësi zgjedh një prej lëndëve artizanale, artistike, tregtare ose teknologjike. Sipas projektit të tij të formimit dhe me disa kushte, nxënësi ka mundësi t'i zëvendësojë OCOM-të me një lëndë me zgjedhje specifike (OS) - ekonomi e drejtësi, italisht ose matematikë e fizikë - dhe/ose të ndjekë një arsimim të drejtimit parajimnazial për frëngjisht, për matematikë, për gjermanisht ose për anglisht.

## Nivelet

Në drejtimin e përgjithshëm, dy nivele parashikohen për frëngjisht, për matematikë dhe për gjermanisht. Niveli 1 përkon me kërkesa bazë, ndërsa niveli 2 përkon me kërkesa më të larta. Nxënësi mund të ndodhet kështu në nivele të ndryshme në këto tri lëndë, gjë që lejon përshtatjen e mësimdhënies sipas aftësive të tij.

## Arsimimi i përforcuar

Nxënësit që ndjekin një arsimim të nivelit 1 në të njëjtën kohë në frëngjisht, në matematikë dhe në gjermanisht përfitojnë nga një mbështetje e veçantë në këto tri lëndë. Këshilli drejtues i entit shkollor vendos për format e kësaj mbështetjeje:

## Riorientimi

Riorientimi nga një drejtim në tjetrin mund të ndodhë në fund të semestrit të 1-rë të vitit të 9-të dhe në fund të vitit të 9-të dhe të vitit të 10-të. Kalimi nga një drejtim në tjetrin mund të ndodhë në fund të çdo semestri, nga fundi i semestrit të 1-rë të vitit të 9-të deri në fund të semestrit të 1-rë të vitit të 11-të. Ndërrimet e drejtimit dhe të nivelit bëhen në bazë të rezultateve shkollore. Vendimet e riorientimit merren prej këshillit drejtues, pasi dëgjohen nxënësi dhe prindërit e tij.

## Lëndët me zgjedhje të kompetencave të orientuara drejt zanateve (OCOM, *options de compétences orientées métiers*) të drejtimit të përgjithshëm

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me OCOM-të gjendet në sitin tonë të Internetit:

[www.vd.ch/scolarite](http://www.vd.ch/scolarite) > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

Riorientimi  
në fund të  
semestrit të 1-rë  
në vitin e 9-të

**Vetëm në vitin e 9-të, nxënësi-ja mund të riorientohet nga drejtimi i përgjithshëm në drejtimin paragjimnazial në fund të semestrit të 1-rë nëse ai/ajo i ndjek të tria lëndët me nivel në nivelin 2, si dhe një lëndë me zgjedhje specifike, dhe nëse merr të gjitha pikat vijuese për grupet I dhe II:**

Grupi I	frëngjisht + matematikë + gjermanisht + shkencat e natyrës + lëndë me zgjedhje specifike	24 pika e sipër
Grupi II	anglisht + gjeografi + histori - etikë e kulturë fetare	13,5 pika e sipër
<i>Rastet limite</i>	<i>e shumta 0,5 pikë pamjaftueshmëri në njerin prej dy grupeve.</i>	

**Për të kaluar nga një nivel në tjetrin** në një lëndë me nivel në fund të semestrit të 1-rë të vitit të 9-të:

- Kalimi nga niveli 1 në nivelin 2 është i mundur për nxënësin që arrin në një lëndë me nivel një mesatare prej:
  - 5,5 e sipër;
  - 5, me mendimin paraprak të mësuesit/es të lëndës.
- Me kërkesën e prindërve ose me mendimin paraprak të mësuesit-es të lëndës, nxënësi mund të kalojë nga niveli 2 në nivelin 1.

Klasat plotësuese  
dhe të rakordimit  
për nxënësit  
e drejtimit të  
përgjithshëm

Shkalla e dytë I (Arsimi i mesëm i ulët) mbyllet me një çertifikatë të përfundimit të studimeve të shkallës së dytë që shënon mbarimin e shkollimit të detyrueshëm. Në fund të një viti studimesh shtesë dhe me disa kushte, klasat:

- plotësuese i mundësojnë nxënësit-es të paçertifikuar në drejtimin e përgjithshëm të marrë çertifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë;
- e rakordimit 1 (Rac1) i mundësojnë nxënësit që ka marrë çertifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të arrijë rezultatet që lejojnë hyrjen në shkollat e kulturës së përgjithshme dhe të tregtisë të gjimnazeve ose maturës profesionale;
- e rakordimit 2 (Rac2) i mundësojnë nxënësit që ka marrë çertifikatën e mbarimit të studimeve të shkallës së dytë të drejtimit të përgjithshëm të marrë çertifikatën e drejtimit paragjimnazial.

### **Paraqitje e ciklit 3**

Një fletëpalosje shpjeguese, lidhur me ciklin 3 dhe në veçanti me vitin e 9-të dhe vitin e 10-të, gjendet në sitin tonë të Internetit: [www.vd.ch/scolarite](http://www.vd.ch/scolarite) > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

### **Çertifikimi në fund të vitit të 11-të**

Një fletëpalosje që paraqet kushtet e çertifikimit të nxënësve të vitit të 11-të dhe kushtet e hyrjes në klasat e rakordimit, në klasat plotësuese, si dhe në formimet pas arsimit të detyrueshëm gjendet në sitin tonë të Internetit: [www.vd.ch/scolarite](http://www.vd.ch/scolarite) > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

### **Klasat e rakordimit**

Një fletëpalosje shpjeguese lidhur me klasat e rakordimit gjendet në sitin tonë të Internetit: [www.vd.ch/scolarite](http://www.vd.ch/scolarite) > Parent information and translated documents - Documents traduits d'information aux parents.

## Struktura e shkollës të detyrueshme vaudeze

		Rac1 dhe Rac2 klasat e mësimit plotësues		shkalla e dytë I (arsimi i mesëm i ulët)
14 - 15 vjeç	11S	cikli i tretë drejtimi i përgjithshëm	cikli i tretë drejtimi paragjimnazial	
13 - 14 vjeç	10S			
12 - 13 vjeç	9S			
11 - 12 vjeç	8P	cikli i dytë fillor		shkalla e parë (arsimi fillor)
10 - 11 vjeç	7P			
9 - 10 vjeç	6P			
8 - 9 vjeç	5P			
7 - 8 vjeç	4P	cikli i parë fillor (përfshirë shkollën foshnjore)		
6 - 7 vjeç	3P			
5 - 6 vjeç	2P			
4 - 5 vjeç	1P			



[www.vd.ch/scolarite](http://www.vd.ch/scolarite)

[www.vd.ch/page/1055372](http://www.vd.ch/page/1055372)

